



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT LUMOR MAT

VENDIM

Nr.6, datë 17.09.2025

PËR

**MIRATIMIN E LEJES PËR PËRDORIM BURIMI UJOR NËNTOKËSOR
PËR QËLLIME INDUSTRIALE, TË SUBJEKTIT “AL-BASALT”
SH.P.K., ME VENDNDODHJE: SKURAJ, NJËSIA ADMINISTRATIVE
MILOT, BASHKIA KURBIN.**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 141, të ligjit nr.29/2024, “Për Burimet Ujore” i ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.550, datë 15.07.2020, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujrave të pëdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimarrjes, të formateve të lejes, të autorizimit, të kushteve të posaçme dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Lumor Mat,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për leje për përdorim burimi ujor nëntokësor për qëllime industriale, të subjektit “Al-Basalt” sh.p.k., me vendndodhje: Skuraj, Njësia Administrative Milot, Bashkia Kurbin.

1. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e burimit ujor:

- X= 480978.9

- $Y = 4618686.2$
 - $Z = 26 \text{ m}$
 - Prurja mesatare : $Q_{\text{mes}} = 2 \text{ l/sek}$
 - Sasia e ujit që jepet në përdorim : $Q = 2 \text{ l/sek}$
 - Qëllimi i përdorimit : Industriale, për larjen e inerteve
 - Thellësia e pus-shpimit: 14.5 m
 - Thellësia e vendosjes së pompës : 8 m
 - Koordinatat e pikës së shkarkimit (KRGJSH)
 - $X = 481040$; $Y = 4616770$; $Z = 24 \text{ m}$
 - Prurja që shkarkohet: $Q = 2 \text{ l/sek}$
2. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBL MAT

TAULANT MALSHI

